

Termat e referencës: “Ekspert për realizimin e një databaze të monumenteve të natyrës në Parkun Kombëtar të Alpeve të Shqipërisë-PKASH” për AdZM Shkodër dhe AdZM Kukës, aktiviteti 2.2

1. Hyrje

Parku Kombëtar i Alpeve të Shqipërisë-PKASH është një nga zonat me vlera të larta natyrore, biodiversitet të pasur dhe monumente unike natyrore. Për menaxhimin efektiv dhe ruajtjen e këtyre vlerave, nevojitet krijimi i një databaze të përditësuar (edhe dixhitale) të monumenteve të natyrës brenda parkut (PKASH), të aksesueshme nga institucionet përkatëse.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), përmes Grantit të financuar nga PONT në Parkun Kombëtar të Alpeve të Shqipërisë-PKASH (PA_028), duke zbatuar Planin Operacional 2025 të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar për këtë qëllim dhe si rrjedhim kërkon për një ekspert të specializuar, që do të hartojë një raport me databazë të plotë dhe funksionale të monumenteve të natyrës në Parkun Kombëtar të Alpeve të Shqipërisë-PKASH.

2. Objektivat

Objektivat kryesore të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

- Identifikimin dhe dokumentimin e monumenteve të natyrës në Parkun Kombëtar të Alpeve të Shqipërisë-PKASH.
- Krijimin e një databaze të strukturuar me informacion të detajuar për secilin monument natyror në PKASH.
- Krijimin e një sistemi digjital për menaxhimin dhe përditësimin e databazës të monumenteve të natyrës në PKASH, të aksesueshme nga institucionet përkatëse.
- Hartimin e rekomandimeve për ruajtjen dhe promovimin e monumenteve të natyrës në PKASH.

3. Detyrat dhe Përgjegjësitë

Fokusi i detyrës do të jetë Parku Kombëtar i Alpeve të Shqipërisë-PKASH sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për krijimin e një Raporti strategjik mbi Integrimin e Aspekteve Socio-Ekonomike në Menaxhimin e Parkut Kombëtar të Prespës-PKP” për AdZM Korçë lidhur me PKP.

Eksperti do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme për raportin që do të hartojë:

- *Identifikimin dhe klasifikimin e monumenteve natyrore sipas kategorive dhe vlerave të tyre.*
- *Përshkrimin e detajuar të secilit monument, duke përfshirë karakteristikat gjeologjike, ekologjike dhe historike.*
- *Krijimin e një databaze digjitale të aksesueshme nga institucionet përkatëse.*
- *Hartimin e një plani për menaxhimin dhe ruajtjen e monumenteve.*
- *Sugjerime për integrimin e databazës në platformat ekzistuese të menaxhimit mjedisor.*

- *Produkti final (raport me databazën e plotë) sipas objektit të procedurës duhet të dorëzohet në format pdf dhe word, në mënyrë elektronike dhe fizikisht brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 5.*

4. Kualifikimet dhe Eksperienca

Eksperti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në shkenca mjedisore, gjeografi, teknologji informacioni, ose fusha të ngjashme.
- Eksperiencë të paktën 5-vjeçare të mëparshme të ngjashme.
- Njohuri të thelluara mbi monumentet natyrore dhe praktikat më të mira për ruajtjen e tyre.
- Aftësi të shkëlqyera për dokumentimin dhe përgatitjen e raporteve teknike.

5. Kohëzgjatja e konsulencës dhe dorëzimi i Produktit

Shërbimi i konsulencës fillon me nënshkrimin e kontratës respektive me ekspertin e shpallur fitues dhe do të përfundojë me dorëzimin e produktit final **brenda 7 (shtatë) javësh nga nënshkrimi i kontratës**, sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për realizimin e një databaze të monumenteve të natyrës në Parkun Kombëtar të Alpeve të Shqipërisë-PKASH” për AdZM Shkodër dhe AdZM Kukës lidhur me PKASH.

6. Buxheti

Buxheti për kryerjen e procedurës së prokurimit shërbim konsulence i referohet zbatimit të linjave të buxhetit të përcaktuara në Planin Operacional 2025 të grantit të financuar nga PONT për PKASH, saktësisht:

- Aktiviteti Nr. 2.2 me objekt "Ekspert për realizimin e një databaze të monumenteve të natyrës në Parkun Kombëtar të Alpeve të Shqipërisë-PKASH" për AdZM Shkodër dhe AdZM Kukës lidhur me PKASH, **parashikuar në vlerën maksimale 10,000 (dhjetë mijë) euro, ku përfshihet me tvsh ose 15% tatim në burim.**

7. Mënyra e Aplikimit dhe afati

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë aplikimin e tyre me:

- CV-në e detajuar dhe
- Ofertën financiare sipas buxhetit të përcaktuar në planin operacional 2025 sipas pikës 6 më sipër

në adresën zyrtare të emailit: info@akzm.gov.al

Afati për aplikim është deri më datë **23 prill 2025** (përfshirë).